

# KPA pushon rivlerësimin për gjyqtaren Regleta Panajoti

Nga [Exit News](#) 01-08-2020 në 10:36



Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka pushuar rivlerësimin për gjyqtaren e Gjykatës së Tiranës, Regleta Panajoti.

Disa javë më parë gjyqtarja Panajoti dha dorëheqje nga posti, kërkesë e cila u pranua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Regleta Panajoti u konfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shtator të 2019, por vendimi u [ankimua](#) nga Komisioneri Publik, duke argumentuar se zonja Panajoti nuk ka bërë deklaram të saktë dhe nuk justifikon të ardhurat e saj.

[Në një artikull të mëparshëm](#) Exit theksoi se konfirmimi i gjyqtares Panajoti çënon besimin e publikut në institucionet e vetingut.